

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6377
E hënë, 2 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Rriten rastet me Covid në Kosovë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OVLUÇK-ja DHE KMDLNJ-ja KANË REAGUAR PASI FAMILJARËT E HYSNI GUCATIT NUK U LEJUAN TË UDHËTOJNË PËR NË HAGË | FAQE 4-5

SPECIALJA

PO U BËNË PADREJTËSI TË PARABURGOSURVE NË HAGË

Moslejimi i vizitave familjare për ish-kryetarin e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka nxitur kritika të shumta ndaj Gjykatës Speciale dhe shtetit të Holandës. Organizata e Veteranëve e Luftës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) një veprim të tillë e kanë vlerësuar shkelje e të drejtave të njeriut. Sipas tyre, askush nuk mund t'i arsyetojë veprimet që pamundësojnë vizitat e familjarëve të ish-kryerëve të UÇK-së të cilët gjenden në paraburgim në Hagë. KMDLNJ-ja ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të kërkojë sqarime nga Ministria për Punë të Jashtme e Holandës për problemet e shaktuara lidhur me vizat për të udhëtuar



AKTUALE



BEDRI HAMZA, KANDIDAT I PDK-SË PËR KRYETAR TË MITROVICËS F. 6

KRIJIMI I MEDIAVE TË REJA RRIT KEQINFORMIMIN F. 5

ZONA INDUSTRIALE NË SHIROKË TË SUHAREKËS PËRFSHIHET NGA ZJARRI F. 6



EKONOMI

SHUMICA E LEHONAVE NË SEKTORIN PRIVAT PO I HUMBIN VENDET E PUNËS F. 8

TAHIRI SIGURON DONACION PËR NDËRTIMIN E TREGUT MODERN NË VLERË PREJ 400 MIJË DOLLARËSH F. 8

KULTURË

EKIPI OLIMPIK SOT PRITET ME CEREMONI SHTETËRORE F. 24

KOK-u NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME KOMITETIN OLIMPIK TË PORTUGALISË F. 12

Kurti kritikon nismën 'Ballkani i hapur' | FAQE 2



Shqipëria riatdhesoi 19 persona nga Siria | FAQE 8



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Maqedonia e Veriut mund të rekomandojë dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19

SHKUP, 1 GUSHT - Maqedonia e Veriut nuk e përjashton mundësinë e aplikimit të dozës së tretë të vaksinës kundër koronavirusit pasi, siç tha ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, priten edhe mutacione të reja të virusit. Filipçe tha se po shqyrtohen të gjitha mundësitë, përfshirë edhe atë që vaksina të bëhet sezonale, ndërsa paralajmëroi edhe masa kufizuese për ata që nuk

janë të vaksinuar. "Priten mutacione të reja në koronavirus, kështu që një nga skenarët e mundshëm është që qytetarët të marrin një dozë të tretë të vaksinës anti-Covid dhe gjithashtu mundësia që ajo të bëhet sezonale. Ne do të diskutojmë për masat e mundshme kufizuese, duke synuar së pari ata që nuk janë vaksinuar, sepse nuk ka nevojë të vendosim rrezik shtesë

njerëzit që janë vaksinuar, duke e ditur se kjo është mënyra e vetme që ne të funksionojmë dhe ta kthejmë jetën tonë në gjendjen normale", tha Filipçe. Deri më tani në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar mbi 530 mijë persona apo rreth 25 për qind e popullatës, prej tyre më shumë 380 mijë apo rreth 18 për qind me dy doza të vaksinës.



Shumica e zjarreve në Turqi janë 'nën kontroll'



ANKARA, 1 GUSHT - Mbi 100 vatra të zjarrit në Turqi janë vënë nën kontroll, thanë të dielën zyrtarët. Ministri për Pyje dhe Agrikulturë, Bekir Pakdemirli, ka shkruar në "Twitter" se pesë vatra zjarri janë ende aktive në destinacionet turistike Antali dhe Mugla, derisa 107 vatra të tjera zjarri janë "nën kontroll". Zjarret në Antali janë aktive në qarqet Manavgat dhe Gundogmus, ndërkaq në Mugla zjarre ka në Marmara, Koycegiz dhe Milas. Policia ka përdorur topa uji që zakonisht përdoren për t'i

shpërndarë njerëzit gjatë protestave për t'i ndihmuar helikopterët dhe zjarrfikësit në Mugla për t'i shuar zjarret. Turistët u evakuuan të shtunën nga shumë hotele në qarkun Bodrum të Muglas tekta zjarret u përhapën në pyjet përreth. Ministri Pakdemirli tha se zjarret në Bodrum janë vënë nën kontroll. Nga zjarret në Turqi, që nisën të mërkurën, kanë vdekur gjashtë persona. Jugu i Evropës po përballet me temperatura të larta që ka çuar në shpërthimin e zjarreve edhe në Itali dhe Greqi.

Irani mohon se e ka sulmuar cisternën e naftës

TEHRAN, 1 GUSHT - Irani ka hedhur poshtë akuzat e Izraelit se Teherani qëndron prapa sulmit ndaj një cisterne të naftës që menaxhohet nga Izraeli. Në sulmin që ndodhi këtë javë pranë brigjeve të Omanit u vranë një britanik dhe një rumun. Sulmi ndaj cisternës së naftës Mercer Street, e cila është nën pronësi japoneze, por që operon nën flamurin e Liberisë, ishte sulmi i parë vdekjeprurës ndaj një anijeje komerciale. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme iraniane, Said Khatibzadeh, në një konferencë për media më 1 gusht, tha se Izraeli ka "krijuar pasiguri, terror dhe dhunë" dhe shtoi se "këto akuzat për përfshirjen e Iranit dënohen nga Teherani". "Me



akuza të tilla, Izraeli ka për qëllim që ta shmangë vëmendjen nga

faktet dhe, si të tilla, ato janë të pabaza", shtoi ai.

Më herët, gjatë ditës, kryeministri izraelit Naftali Bennet akuzoi

Iranin se po "mundohet ta minimizojë përgjegjësinë" për incidentin. Më 31 korrik Marina amerikane tha se sulmi ishte kryer me dron dhe se luftanijet amerikane e kanë përcjellë deri në port cisternën që u sulmua. Cisterna Mercer Street menaxhohet nga Zodiac Maritime, me seli në Londër, që është pjesë e grupit Zodiac të miliardit izraelit Eyal Ofer. Ndërkaq, ministri i Jashtëm izraelit, Yair Lapid, ka akuzuar Iranin për sulmin ndaj cisternës dhe ka thënë se Irani është "shortues i terrorizmit, shkatërrimit dhe paqëndrueshmërisë që na dëmton të gjithë ne".

Schmidt merr detyrën e përfaqësuesit të lartë në Bosnje e Hercegovinë

SARAJEVË, 1 GUSHT - Gjermani Christian Schmidt më 1 gusht merr detyrën e përfaqësuesit të lartë në Bosnje e Hercegovinë. Schmidt zëvendëson diplomatit austriak Valentin Izko i cili shërbeu për 12 vjet si zyrtari më i lartë i Kombeve të Bashkuara në Bosnje e

Hercegovinë, post ky që ka për synim mbrojtjen e aspekteve civile dhe sundimin e ligjit të marrëveshjes së paqes të arritur më 1995. Schmidt, 63-vjeçar, ka reputacion të një politikani të fortë rajonal dhe federal, i cili nuk ngurron të ndër marrë vendime

kontroverze. Përfaqësuesi në largim, Inzko së fundmi ishte përballur me kritikën e Rusisë dhe Kinës, shtete këto që muajin e kaluar dështuan të paraqisnin një propozim të përbashkët për të larguar nga Bosnja postin e përfaqësuesit të lartë.



Kurti kritikon nismën 'Ballkani i hapur'

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka komentuar takimin e tri shteteve fqinje për "mini-Shengenin", që tashmë po quhet "Ballkani i hapur". Kurti ka thënë se problemi kryesor në Ballkanin Perëndimor është mosballafaqimi i Aleksandër Vuçiqit me të kaluarën. "Nuk mund të them se jam i entuziazmuar me emërtimin 'Ballkani i hapur', pasi që duke qenë aty kreu i Serbisë që nuk ballafaqohet me të kaluarën e shtetit të tij dhe të vetes së tij, 'Ballkani i hapur' ngjan më shumë si Ballkan i hapur për ndikimet nga Lindja, sidomos nga Federata Ruse", ka thënë Kurti

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, të dielën ka thënë se nisma "Ballkani i hapur" (Open Balkan) më shumë i ngjan një "Ballkan të hapur për ndikimet nga Lindja" sesa një nisme për treg të përbashkët për vendet e rajonit. Sipas Kurtit, kjo nismë, ku bëjnë pjesë Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, duhet të shoqërohet edhe me ballafaqimin me të kaluarën e

Serbisë dhe të presidentit të saj, Aleksandër Vuçiq. Ai ka thënë se Serbia ka shkaktuar katër luftëra në dekadën e fundit të shekullit 20. "Nuk mund të them se jam i entuziazmuar me emërtimin 'Ballkani i hapur', pasi që duke qenë aty kreu i Serbisë që nuk ballafaqohet me të kaluarën e shtetit të tij dhe të vetes së tij, 'Ballkani i hapur' ngjan më shumë si Ballkan i hapur për ndikimet nga Lindja, sidomos nga Federata Ruse, por edhe nga Kina si dhe Ballkan i hapur



për autokracinë, për korrupsionin, për kriminelët e luftës të cilët, siç e dimë të gjithë ne, vazhdojnë të jenë masivisht, jo vetëm të lirë në Serbi, por edhe jo pak prej tyre edhe në pushtet", ka thënë Kurti për mediat në Prishtinë. Më 29 korrik në Shkup u

takuan kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev.

Të tre liderët ftuan vendet e rajonit që t'i bashkohen nismës së "mini-Shengenit" që mori

emërtimin e ri "Ballkani i hapur". Në këtë takim nuk mori pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Sipas Ramës, Vuçiqit dhe Zaevit, "Ballkani i hapur" ka për qëllim të krijojë një treg të përbashkët për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Shqipëria riatdhesoi 19 persona nga Siria

TIRANË, 1 GUSHT - Në Shqipëri të dielën janë riatdhesuar 14 fëmijë dhe pesë gra që gjendeshin në kampin Al-Hol në Siri.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ky ishte një operacion i ndërlikuar, por që autoritetet do t'i vazhdojnë përpjekjet që të kthejnë edhe persona të tjerë. "Është vërtet një ngjarje pozitive dhe sigurisht se ne nuk do të ndalemi këtu. Ka edhe një operacion tjetër potencial për t'u zhvilluar, me një numër që ende nuk e dimë saktësisht sepse është një punë terreni për t'i gjetur personat në ato vrime të zeza ku gjenden. Por, llogaritim një numër pak a shumë të njëjtë me këtë të sotmin, në mos pak më i vogël", ka thënë Rama.

Shqipëria është vendi i dytë në rajon që, krahas Kosovës, ka bërë riatdhesimin e qytetarëve pjesëmarrës në luftërat në Siri. Në të dyja vendet të kthyerit nga këto vatra lufte u nënshtrohen proceseve gjyqësore dhe programeve të rehabilitimit dhe reintegrimit. Fillimisht të riatdhesuarit do të vendosen në Durrës për ekzaminim shëndetësor para

se t'u kthehen familjeve ose qendrave të specializuara.

Të kthyerit nga kampi sirian Roj, që kishin kaluar kohë paraprakisht në kampin famëkeq al-Hol, u pritën në dalje të avionit special në pistën e aeroportit të Rinasit nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ministri i Brendshëm Bledi Cuci, të cilët shoqëruan fëmijët drejt aeroportit.

Kryeministri Rama, po ashtu, tha se kanë identifikuar dy persona të cilët kanë refuzuar që të riatdhesohen dhe shtoi se tërheqja me forcë e personave që refuzojnë të kthehen, është "e pamundur".

Ndërkaq, drejtori i Departamentit Anti-Terror pranë policisë shqiptare, Gledis Nano, njoftoi se shqiptarët e mbetur në kampet e Shtetit Islamik nuk janë treguar aspak bashkëpunues me autoritetet shqiptare dhe se zyrtarët shtetërorë po punojnë për identifikimin e vendndodhjes së atyre që i kanë mbijetuar disfatës së grupit militant, Shteti Islamik. Kjo është hera e dytë që Shqipëria organizon riatdhesimin e qytetarëve të saj që iu kishin bashkëngjitur



organizatave terroriste në Siri dhe Irak gjatë periudhës 2012-2015.

Numri i përgjithshëm i të kthyerve nga kampet e IS-it në

Shqipëri arrin në 24, por mbetet e paqartë se cili është numri i përgjithshëm i shtetasve shqiptarë që mbetin në këto kampe. Rreth 70 shtetas

shqiptarë besohet se i janë bashkuar organizatës terroriste Shteti Islamik, ndonëse konfirmim zyrtar të numrit të tyre nuk ka.



OVLUÇK-JA DHE KMDLNJ-JA KANË REAGUAR PASI FAMILJARËT E HYSNI GUCATIT
NUK U LEJUAN TË UDHËTOJNË PËR NË HAGË

Specialja po u bënë padrejtësi të paraburgosurve në Hagë

Moslejimi i vizitave familjare për ish-kryetarin e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka nxitur kritika të shumta ndaj Gjykatës Speciale dhe shtetit të Holandës. Organizata e Veteranëve e Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) një veprim të tillë e kanë vlerësuar shkelje e të drejtave të njeriut. Sipas tyre, askush nuk mund t'i arsyetojë veprimet që u pamundësojnë vizitat e familjarëve të ish-krerëve të UÇK-së të cilët gjenden në paraburgim në Hagë. KMDLNj-ja ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të kërkojë sqarime nga Ministria për Punë të Jashtme e Holandës për problemet e shkaktuara lidhur me vizat për të udhëtuar

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 GUSHT - Familjarët e ish-kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, nuk kanë mundur ta vizitojnë të afërmin e tyre i cili gjendet në paraburgim në Hagë që rreth një vjet. Ata kanë bërë me dije se kjo ka ndodhur për shkak se shteti holandez nuk i ka pajisur me viza. Kjo ka nxitur reagime të shumta në shoqëri, duke akuzuar Gjykatën Speciale dhe shtetin holandez se po i shkel të drejtat e njeriut.

Organizatave e dala nga lufta e UÇK-së dhe KMDLNj-ja kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës të kërkojnë sqarime nga

Ministria për Punë të Jashtme e Holandës për problemet e shkaktuara lidhur me vizat. Sipas tyre, vizat për familjarët duhet të jenë afatgjata.

U.d. kryetari i OVLUÇK-së, Faton Klinaku, në një konferencë të jashtëzakonshme për media ka deklaruar se kjo është një padrejtësi që po bëhet ndaj ish-pjesëtarët e UÇK-së. "Kemi thirrur këtë konferencë të jashtëzakonshme për shkak se familjes së Hysni Gucatit iu është refuzuar vizita që ta vizitojnë atë në Hagë ku po mbahet në paraburgim. Si organizatë, përveç kësaj padrejtësi, ne kemi shfaqur edhe më herët padrejtësi që po u bëhen dhe do t'u bëhen (të paraburgosurve) nga kjo

gjykatë politike e cila është miratuar nga deputetë faqazi të Kosovës. Përveç që e kanë miratuar një gjykatë politike, e cila nuk ndjek krimet, por ndjek pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke ditur këtu që Serbia ka kryer krime dhe masakra dhe nuk i ndjek askush", ka thënë Klinaku.

Ndërkaq Musli Gucati, djali i Hysni Gucatit, ka treguar se atyre po u bëhet padrejtësi e madhe pasi që nuk po mund ta takojnë babanë e tyre. "Gjithë dokumentacioni është përgatitur. Ka një muaj që kemi përgatitur dokumentet. Ministria e Drejtësisë ka kryer detyrat e saj me përgjegjësi. Ka pagur biletat dhe familjarët që kanë pasur të udhëtojnë janë

vaksinuar në kohë. Autoritetet holandeze kanë bërë një padrejtësi të madhe. Është bërë një vit që nuk kemi pasur kontakte fizike me babanë, kinse nuk kemi mjete financiare", është shprehur ai.

KMDLNj: S'mund të arsyetohen veprimet që i pamundësojnë vizitat e familjarëve në Hagë

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), i cili edhe më parë ka reaguar për trajtimin që Specialja po ua bënë të paraburgosurve, ka vlerësuar se nuk mund të arsyetohet asnjë veprim që i pamundëson vizitat e familjarëve në Hagë. "Nëse, për shkak të situatës emergjente, ishin marrë këto masa kufizuese në mbrojtje të shëndetit të tyre, tash nuk mund të arsyetohet veprimi që u pamundëson familjarëve të Hysni Gucatit ta vizitojnë anëtarin e familjes. Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë përmes Zyrës për Mbështetje, ka marrë përgjegjësinë konkrete t'i mbulojë të gjitha shpenzimet për vizita si dhe të ndihmojë në

sigurimin e vizave. Tash refuzimi i Holandës për t'u dhënë viza familjarëve të Hysni Gucatit është në kundërshtim të plotë me marrëveshjen e nënshkruar dhe shkelje flagrante e të drejtave të njeriut dhe Rregullave Evropiane të Burgjeve e të mos flasim për Rregullat e Nelson Mandelës që i ka adoptuar kjo gjykatë, si standard më i lartë i trajtimit", ka vlerësuar KMDLNj-ja në reagimin për media.

Këshilli ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të kërkojë sqarime nga Ministria për Punë të Jashtme e Holandës për problemet e shkaktuara lidhur me vizat. "Edhe avokatët mbrojtës të licencuar nga kjo gjykatë po përballen me shumë vështirësi gjatë pajisjes me viza. Në anën tjetër ka shumë vonesa për përkthimin e materialeve për të akuzuarit apo ato përkthehen vetëm pjesërisht e që ndikon në përgatitjen e mbrojtjes duke mohuar të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të pandikuar. KMDLNj proteston kundër këtyre shkeljeve flagrante nga Gjykata Speciale dhe kërkon nga Qeveria e Kosovës të kërkojë sqarime nga Ministria për Punë të Jashtme e

Holandës për problemet e shkaktuara lidhur me vizat duke këmbëngulur që vizat, si për familjarët ashtu edhe për avokatët, të jenë afatgjata”, ka vlerësuar ky këshill.

Ndër të tjera, KMDLNj ka kërkuar edhe nga deputetët që këto çështje t'i diskutojnë në kuvend. “Për aq kohë sa zgjatë puna e Gjykatës Speciale, familjarët dhe avokatët mbrojtës duhet të pajisen me pasaporta zyrtare. KMDLNj kërkon që deputetët e Kuvendit të Kosovës në njërin nga seancat në vjeshtë të diskutojnë për këto probleme

nëse ende mendojnë se kjo gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës. Në të kundërtën, duhet të distancohen nga përgjegjësia duke e adresuar përgjegjësinë konkrete te BE-ja dhe Gjykata Speciale”, ka bërë me dije KMDLNj.

Edhe avokati i njohur Tomë Gashi ka kritikuar Gjykatën Speciale se është duke i shkelur të drejtat e të paraburgosurve. Ai ka deklaruar se prokuroria e kësaj gjykate ende nuk ia ka dorëzuar mbrojtjes provat e aktakuzës me të cilën rëndohen të paraburgosurit

sikurse nuk e ka njoftuar mbrojtjen se kush janë dëshmitarët që do të dëshmojnë ndaj ish-krerëve të UÇK-së. “Mendoj që Prokuroria ka bërë tepër pak në raport me drejtësinë ngaqë deri më tani shumë pak prova të cilat duhet të jenë mbështetje e aktakuzës ua ka dorëzuar avokatëve mbrojtës. Për këtë arsyeje, të gjithë avokatëve u janë dhënë shkresa të pamjaftueshme dhe nuk i kanë furnizuar me materiale të cilat avokatët i kanë të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre. Pjesa tjetër e dëmshme

është që prokuroria ende nuk e ka njoftuar mbrojtjen se kush janë dëshmitarët që do të dëshmojnë, cili është kredibiliteti i tyre, çfarë dëshmish kanë ata, pastaj nuk janë njoftuar ende me dëshmitarë të mbrojtur”, ka thënë Gashi, duke theksuar se prokuroria është duke bërë punë jashtëzakonisht të vogël. “Nëse prokuroria ka pasur një kohë të mjaftueshme, ka pasur vite të tëra për të hetuar, për t'i ngritur dyshimet dhe pastaj për të ngritur aktakuza. Kjo kohë e nevojshme duhet t'i lejohet edhe mbrojtjes, edhe pse në

njëfarë mënyre është e dëmshme për shkak se të gjithë këta gjenden në qendrën e paraburgimit në Hagë”, ka deklaruar Gashi. Sipas tij, prokuroria nuk po i jep kohën e duhur mbrojtjes së ish-krerëve të UÇK-së për t'u përgatitur. Për shkak të pandemisë Covid-19, të gjitha vizitat familjare dhe të mbrojtësve për ish-krerët e UÇK-së ishin ndaluar dhe komunikimi bëhej përmes skypit apo telefonave. Gjykata Speciale ka njoftuar se nga 15 korriku lejohen vizita e familjarëve për të paraburgosurit.



Krijimi i mediave të reja rrit keqinformimin

PRISHTINË, 1 GUSHT - Keqinformimi dhe gjuha e urrejtjes janë mjaft të pranishme në mediat e Kosovës. Kjo tendencë, sipas Bordit Ndërkombëtar të Kërkimit dhe Shkëmbimeve (IREX), është veçanërisht e pranishme në mediat në internet që prodhojnë lajme me një burim të vetëm.

Jeton Mehmeti, autor i raportit të IREX-it, në pjesën ku flitet për Kosovën, ka shpjeguar për Radion Evropa e Lirë se, përkundër rritjes së numrit të mediave në Kosovë, kualiteti i lajmeve është në rënie e sipër. Ai thotë se në raport përmenden fakte se dezinformatat dhe gjuha e urrejtjes janë mjaft të pranishme në media, sidomos në vitet elektorale. “Gjuha e urrejtjes në media është shpeshtuar. Një prej burimeve të mesazheve urrejtëse dhe dezinformative janë edhe deputetët të cilët, duke u fshehur prapa imunitetit, lëshojnë deklarata të paverifikuara gjatë diskutimeve parlamentare e të cilat pastaj publikohen edhe nga disa media. Edhe sondazhet me qytetarët e Kosovës tregojnë se

përhapja e dezinformative, propagandës dhe gjuhës së urrejtjes janë prej arsyeve kryesore që qytetarët nuk u besojnë disa mediave”, thotë Mehmeti.

Faktorët të cilët nxisin urrejtjen kanë ardhur si pasojë e mungesës së burimeve të mjaftueshme, me ç'rast, sipas Mehmetit, një numër i madh i përmbajtjes që publikohet nga mediat ka mungesë të burimeve të shumëfishta të besueshme. “Shumë raportime janë të bazuara në opinione apo deklarata të vetme të politikanëve apo individëve. Kjo praktikë ka bërë që shumë shkrime të kenë mungesë të kontekstit dhe elaborimit”, thotë Mehmeti për “Radion Evropa e Lirë”.

Megjithatë, në raportin e organizatës thuhet se mediat e Kosovës ofrojnë informacion cilësor për një shumëllojshmëri temash dhe se mediat kryesore prodhojnë informacion bazuar në fakte.

Në raportin e IREX-it thuhet se kualiteti i informimit dhe konsumi dhe ndërveprimi me informacionin kanë pranuar pikët

më të ulëta, duke theksuar se mediat dhe sektorët e informimit nuk kanë arritur që t'i plotësojnë në tërësi standardet ndërkombëtare për kualitetin e informimit.

Aty thuhet se mediat online janë rritur shpejt, duke nxitur shumëllojshmëri në kanalet e informimit. Kjo rrjedhje e informacioneve, megjithatë, nuk do të thotë që qytetarët e Kosovës kanë aftësinë dhe veglat e duhura të edukimit medial. Panelistët e përpilimit të raportit kanë theksuar se këto mangësi i lënë konsumatorët të ndjeshëm ndaj lajmeve të rreme. Megjithatë, panelistët gjithashtu shprehën besimin se keqinformimi dhe gjuha e urrejtjes janë mjaft të pranishme në media.

Pikët më të ulëta nga 20 indikatorët iu dhanë indikatorit Barometri i Informimit të Pastër (VIBE) në burimet për prodhimin e përmbajtjes, duke lënë të kuptohet se mediat prodhojnë një sasi të madhe të lajmeve pa burime të mjaftueshme. Ky trend është veçanërisht i pranishëm në

mediat online, që po rriten në numër dhe që prodhojnë lajme një-burimore.

Krijimi i mediave të reja dhe nxitja e gjuhës së urrejtjes

Edhe Zekirja Shabani, njohës i mediave në Kosovë, njëherësh ish-kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se gjuha e urrejtjes dhe keqinformimi në Kosovë çdo ditë e më shumë po rriten. “Krijimi i mediave të reja, përveç anës pozitive që ka me rritjen e pluralizmit medial, po ndikon edhe në rritjen e pakënaqësive ose nxitjen e gjuhës së urrejtjes. Mediat online, kryesisht ato që nuk kanë as adresë, as gazetar e as redaktor, po shfrytëzohen nga grupet e caktuara të interesit si mjete propagande në çështje politike apo lëmenj të tjerë”, thekson Shabani.

Drejtoresha ekzekutive e Asociacionit të Mediave të

Pavarura Elektronike të Kosovës, Ardita Zejnullahu, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se të gjitha gjetjet e raportit të IREX-it sa i përket Kosovës qëndrojnë. Ajo thotë se për dallim nga mediat audiovizuale, ku gjuha e urrejtjes është më pak e pranishme, në mediat online ajo është shumë e pranishme. “Në mediat online kjo dukuri është shumë e pranishme, pasi ato vetë janë subjekt i vetërregullimit, po mendoj nuk ka ndonjë mjet sanksionues për keqinformim ose dezinformim ose për gjuhën e urrejtjes”, shprehet Zejnullahu.

Shabani thotë se Kosova ka ligje të mjaftueshme të cilat do të mund ta rregullonin mirë funksionimin e mediave në përgjithësi. Nga ana tjetër, profesori universitar dhe sociologu Fadil Maloku konsideron se gjuha e urrejtjes në mediat e Kosovës pa përjashtim është e tepruar. Ai mendon se ajo që është duke ndodhur ka qëllimin e përfitimave të audiencës dhe klikimeve gjë që, sipas tij, ndikon keq në opinionin e gjerë.

Zona Industriale në Shirokë të Suharekës përfshihet nga zjarri

SUHAREKË, 1 GUSHT (ER) - Zona Industriale në Shirokë të Suharekës është përfshirë të dielën nga zjarret. Kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj,

ka thënë se gjendja është serioze teksa ka kërkuar ndihmë nga të gjithë ata që mund të ndihmojnë. "Situata është serioze nga përfshirja e

zjarreve në Zonën Industriale në Shirokë. Të gjitha ekipet e zjarrfikësve janë në teren, po ashtu kemi kërkuar ndihmë edhe nga Prizreni dhe

Mamusha. Të gjithë ata që mendojnë se mund ta japin ndihmë e tyre me cisterna private i ftoj të na ndihmojnë", ka thënë Muharremaj.



Bëhen homazhe te varri i ish-komandantit të UÇK-së, Rahim Beqiri

KAMENICË, 1 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me ish-komandantin e Zonës Operative të Karadakut, Ahmet Isufi, kryetarin e OVLUÇK-së në Kamenicë, Milaim Limoni, veteranë të luftës, familjarë të ish-komandantit Rahim Beqiri, si dhe zyrtarë të tjerë komunalë, kanë bërë homazhe në Kopërnice dhe

te varrezat e dëshmorëve në Kamenicë, në 20-vjetorin e rënies së ish-komandantit Rahim Beqiri. I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka thënë se përjetë do të jetë mirënjohës për të gjithë që sakrifkuan e dhanë jetën për liri. "Sot nderuam veprën dhe kontributin për liri të Rrahim Beqirit (Komandant 'Rokut') në 20-vjetorin e rënies së tij. Së

bashku me ish-komandantin e Zonës Operative të Karadakut, Ahmet Isufi, kryetarin e OVLUÇK-së në Kamenicë, Milaim Limoni, kolegë e veteranë të luftës, bëme homazhe në Kopërnice dhe te varrezat e dëshmorëve në Kamenicë. Përjetë mirënjohës gjithsecilit që sakrifkoi dhe dha jetën për lirinë që sot e gëzojmë", ka thënë Kastrati.



Bedri Hamza, kandidat i PDK-së për kryetar të Mitrovicës

MITROVICË, 1 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka zyrtarizuar kandidaturën e Bedri Hamzës për kryetar të komunës së Mitrovicës. "Nga një qytet me rëndësi të veçantë siç është Mitrovica, dhe nga një vend i kujtimeve të mira siç është embëltoja 'Ballkan', jam shumë i lumtur ta shpërndaj një lajm po ashtu të veçantë, të mirë e të rëndësishëm që do t'i flladitë zemrat e qytetarëve të Mitrovicës. Bedri Hamza është

kandidati i PDK-së për Mitrovicën në zgjedhjet e tetorit", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook". Lideri i PDK-së ka thënë se kandidatura e Hamzës është një fat i mirë dhe i rrallë, që me padurim do të përqafohet nga të gjithë qytetarët për t'i dhënë fund talljes së gjatë me qytetin e tyre, e për t'i dhënë seriozisht shans jetës që ata e meritojnë. "Sepse, të gjithë pajtohen: S'ka si Bedri Hamza!", ka shkruar Krasniqi.



Largohet deponia e bërllokut në lagjen Dobrunaj në Deçan

DEÇAN, 1 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se në lagjen Dobrunaj ka larguar një deponi e cila ishte

pengesë për ambientin përreth. Ai ka kërkuar nga qytetarët që të kenë më tepër konsideratë dhe mos të hedhin mbeturina në vende të

palejuara. "Të kontribuojmë së bashku për një qytet të pastër", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Komuna e Kamenicës organizon ecje 'Ta njohim trashëgiminë'

KAMENICË, 30 KORRIK (ER) - Në kuadër të manifestimit "Ditët e Diasporës 2021", të shtunën më 31 korrik 2021, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Kamenicës, organizon ecje në fshatin Meshinë "Ta njohim trashëgiminë". Gjatë kësaj ecje 3.5 kilometra në gjithë fshatin Meshinë do

të vizitohen objektet e vjetra si mullinj, shtëpi, stalla dhe xhamia e fshatit. Do të ketë edhe ekspozitë me eksponate etnografike nga fshati, si dhe një drekë me ushqime tradicionale. "Terreni që do të vizitohet është i rrafshët, i lehtë për ecje, me hije të shumta e me burime uji, me përroin e

fshatit që kalon krahas rrugës, gjithashtu i përshtatshëm edhe për fëmijë dhe moshë më të vjetra. Ftojme të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në këtë aktivitet i cili është falas. Nisja bëhet nga komuna me autobus me fillim nga ora 10:00", ka njoftuar komuna e Kamenicës.



Rriten rastet me Covid në Kosovë



Të dielën nga 2 849 testime, 100 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), numri i rasteve aktive është 539

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Të dielën Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se nga 2 849 testime, 100 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të dielën janë shëruar edhe tre qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 660. Në total numri i rasteve aktive është 539. Zyrtarë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) kanë bërë me dije se rreth 90 për qind të rasteve të infektimit me Covid në Kosovë janë të lidhura me variantin "Delta" të këtij virusi. Sipas tyre, ky variant, sikur edhe në shumë vende të botës, është dominues

edhe në Kosovë. Përveç variantit "Delta", rreth 7-8 për qind e rasteve të infektimit janë me variantin "Alfa", derisa në këtë shtet nuk ka prani të varianteve "Beta" dhe "Gama". "Para tre-katër muajsh varianti 'Alfa' ose ai britanik ishte në 98 për qind të rasteve, tani është vetëm 7-8 për qind të izolanteve, ndërsa nuk gjen izolante të variantit të Afrikës së Jugut ose brazilian. Tani ka ndryshuar situata, duke qenë mbizotërues varianti 'Delta' në javët e fundit. 80 deri në 90 të izolanteve të koronavirusit janë të variantit 'Delta', ka thënë Xhevat Jakupi nga Departamenti i Mikrobiologjisë në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Ndërkaq javën e kaluar në një konferencë për media, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka

paralajmëruar për rritje të numrit të të infektuarve me Covid-19 si pasojë e përhapjes së variantit "Delta" të këtij virusi. Sipas tij, arma e vetme kundër pandemisë është vaksinimi. "Sot kur vendi ynë ka vakcina për secilin qytetar dhe kur qytetarët mund ta zgjedhin vaksinën, kur janë hequr kategoritë e vaksinimit, nuk ka arsye të vetme për të mos u vaksinuar", ka thënë Vitia.

Vitia ka thënë se interesim më i madh për t'u vaksinuar vërehet në Prishtinë, derisa ka qytete të tjera që janë duke treguar më shumë hezitim. Sipas ministrit Vitia, Kosova aktualisht ka kapacitet për të vaksinuar 16 mijë deri në 20 mijë persona në ditë, mirëpo ky vend është ende larg caktimit të imunitetit të 60 për qind të popullatës kundër Covid-19, sëmundjes që shkakton ky

virus.

Ministri Vitia ka thënë se Ministria e Shëndetësisë ka punuar për ta shtrirë oksigjenimin qendror aty ku ka munguar në spitalet e Kosovës, si dhe janë bërë intervenime urgjente ku është parë se ka pasur nevojë gjatë valëve paraprake të pandemisë.

Qendrat për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (CDC) në Shtetet e Bashkuara kanë thënë se varianti "Delta" i koronavirusit përhapet me aq lehtësi sa lia e dheneve, e njohur edhe si lija e ujit, dhe se mund të shkaktojë sëmurje të rëndë, ka raportuar e përditshmja amerikane "New York Times", duke cituar një dokument të brendshëm të CDC-së. Megjithatë, të dhënat e CDC-së tregojnë se vaksinat janë shumë efektive për parandalim të sëmurjes serioze, shtrirjes në spital dhe vdekjeve, është thënë në raport, duke cituar ekspertët. Muajin e kaluar një studim ka treguar se 99 për qind e vdekjeve me koronavirus janë regjistruar

në mesin e të pavaksinuarve.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës (SBASHK) përmes një komunikate për media ka thënë se është shqetësues fakti se deri tani një numër i vogël i punëtorëve arsimorë janë vaksinuar. "SBASHK-u u drejtohet të gjithë anëtarëve që t'i heqin dilemat e hezitimeve eventuale dhe të vaksinohen me qëllim që të jenë të mbrojtur dhe të kontribuojnë në fillimin e mbarë të vitit shkollor në gjithë institucionet arsimore kudo në Kosovë", thuhet në komunikatën e SBASHK-ut.

SBASHK-u kishte kërkuar nga ministri Arben Vitia që punëtorët arsimorë të kenë prioritet për vaksinim. "Ne kemi dëgjuar vazhdimisht kërkesat tuaja legjitime dhe kemi bërë gjithë të mundurën që t'i realizojmë ato. Jemi të sigurt se edhe ju do ta dëgjoni apelin tonë dhe do të shkoni në qendrat e vaksinimit", është theksuar në komunikatën e SBASHK-ut.

Gjoshi: Kurti po u ik debateve televizive me analistë dhe gazetarë

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Zyrtari i Partisë Demokratike të Kosovës (PKD), Betim Gjoshi, përmes një postimi në

llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar të dielën se që 141 ditë Albin Kurti është kryeministër dhe të gjitha debateve

televizive me analistë e gazetarë u ka ikur me sukses. "Ai nuk po ka guxim të sfidohet nga asnjë panel dhe me asnjë pyetje. Çfarë

kryeministri që nuk guxon të debatojë për 'punën' e vet. Në fakt, e gjithë jeta e tij karakterizohet nga ikja", ka shkruar Gjoshi.



Ministri i Bujqësisë nënkruan programin për pagesa të drejtpërdrejta

Prishtinë, 1 gusht (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka nënkruar Programin për Pagesa Direkte - Subvencione për vitin 2021, ku përkrahja financiare

vetëm për këtë vit kalendarik për fermerët në kategorinë e subvencioneve arrin vlerën e rreth 50 milionë eurove. “Nënshkrova Programin e P a g e s a v e Direkte/Subvencioneve për vitin 2021 i cili do të jetë një

përkrahje për të gjithë fermerët të cilët përmes këtij programi do ta kenë mundësinë e ushtrimit dhe zgjerimit të aktiviteteve të tyre bujqësore dhe blegtorale, në dobi të komunitetit dhe zhvillimit

ekonomik të vendit”, ka thënë ministri Peci me rastin e nënkruimit të programit. Vlen të theksohet se kanë mbetur tashmë vetëm procedurat ligjore dhe administrative deri te hapja e aplikimit.



Shumica e lehonave në sektorin privat po i humbin vendet e punës

PRISHTINË, 1 GUSHT - Papunësia e gjinisë femërore në Kosovë dhe çështja e pushimit të lehonisë për gratë shtatzëna të cilat punojnë në sektorin privat mbeten ende probleme të pazgjidhura në vend. Ligji i punës që është aktualisht në fuqi parasheh 12 muaj pushim për lehonat. Nëntë muaj aktualisht janë me pagesë dhe tre të tjerë pa pagesë.

Gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70 për qind të pagës bazë. Tre muajt në vijim pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50 për qind të pagës mesatare në Kosovë, por rregullimi i pushimit të lehonisë në këtë formë po del të jetë barrë për sektorin privat.

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka

thënë për “KosovaPress” se është kërkesë e kamotshme e tyre që të ndryshohet ky ligj. Sipas tij, bizneset private po mbështetin formatin që tre muajt e parë të pushimit të lehonisë të paguhet nga kompania, kurse gjashtë muajt e tjerë të paguhet nga Qeveria e Kosovës. E ky ligj, sipas Azemit, ka bërë që shumë pronarë të mos preferojnë punonjëse të martuara, ndërsa edhe ato që i kanë po i largojnë.

Ai potencoi se ka shumë gra të cilat i ikin lindjes së fëmijëve vetëm që mos të largohen nga puna. Kurse Bardha Çollaku, menaxhere në kopshtin “Bardha Akademi” në Prishtinë, shprehet se në institucionet parashkollore private pothuajse të gjitha punëtoret janë të gjinisë femërore. Andaj, ky ligj po u sjell mjaft telashe.



Tahiri siguron donacion për ndërtimin e tregut modern në vlerë prej 400 mijë dollarësh

VUSHITRI, 1 GUSHT (ER) - Komuna e Vushtrrisë shumë shpejt do të bëhet me treg të ri modern. Të dielën kryetari i kësaj komune, Xhafer Tahiri, ka nënkruar marrëveshje me organizatën Islamic Relief, dega në ShBA, në vlerë prej 400 mijë dollarësh. Tahiri ka thënë se kjo është prej marrëveshjeve më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik lokal të qytetit të Vushtrrisë, e cila ka të bëjë me ndërtimin e tregut për prodhues vendorë. “Tregu do të jetë hapësirë multifunkionale që ngërthen në vete hapësirën për prodhues vendorë, zejtarë, hapësira të gjelbra, kënde për lodra të fëmijëve, restorante, parkingje për makina dhe biçikleta në hapësirë 1.5 hektar. Kur të përfundoj projekti, çdo prind mund t’i marrë fëmijët e tyre përdore dhe t’i dërgojë në treg për



t’ia mësuar tregtinë”, ka thënë ai. Tahiri ka theksuar se ky treg, përveç aspektit ekonomik e zhvillimor, do

ta ketë edhe dimensionin social. “Do të ketë edhe dimensionin tjetër që do të tërheqë shumë

vizitorë edhe nga Kosova edhe nga jashtë sepse është një prej tregjeve më unike që do të bëhet jo vetëm

në Kosovë, por në të gjitha hapësirat e tjera shqiptare”, ka deklaruar kryetari Tahiri.

Përfundimi i pandemisë, “Amazon”, po sheh ulje të shitjeve


PRISHTINË, 1 GUSHT - “Amazon” ka parashikuar rritje më të ngadaltë të shitjeve në tremujorin e tretë, ndërsa një nxitje nga pandemia po ulet. Klientët iu drejtuan “Amazon”-it dhe platformave

të tjera online gjatë krizës Covid-19, duke çuar në fitime rekord për gjigantin amerikan. Por rritja marramendëse e “Amazon”-it ka filluar të nivelohet, ndërsa klientët fillojnë të kthehen në dyqanet

normale. Të ardhurat u rritën me 27 për qind në 113 miliardë dollarë në tremujorin e dytë, por kjo humbi pritjet e analistëve. Aksionet e “Amazon”-it ranë më shumë se 7 për qind një

ditë më parë. “Amazon” kishte fitime rekord, ku regjistroi më shumë se 200 milionë klientë në shërbimin e saj “Prime” dhe rekrutoi më shumë se 500 mijë punëtorë pas rritjes së kërkesës.





ERNEST BRAMAH

PUNË DREQI

Zoti Braun u mat ta ulte shikimin që ta shihte grykën e revoles kur atë çast ia ndali dorën një zhurmë - një thirrje - diku në shkallën e bllokut të apartamenteve ku banonte. Kishte tri arsye se përse në atë çast të jashtëzakonshëm ai ishte aq i ndjeshëm ndaj një ndikimi aq të vockël: klithma që çuditërisht e melodishme, ndërsa nga natyra dhe zeja dëgjuesi ishte muzikant; ajo thirrje që jo vetëm e melodishme por, çuditërisht, edhe parake fare. Dhe, me ç'dukej, nënkuptonte një thëngjill. Ishte pikërisht mungesa e një malli të tillë që e shtyu muzikantin të kryente atë veprim të rrëmbyer. Një shkas fort i vogël që solli një pasojë aq të madhe, mund të vihet në dukje. Dhe, mbase qe ashtu, mirëpo meqë kishte karakter prej artisti, zoti Braun rrinte krejtësisht jashtë normës së zakonshme të sjelljes së arsyeshme.

Vërtet ai s'kishte pse të ankohej për atë punën e thëngjillit. I paralajmëruar si nga përvoja e dimrit të shkuar, ashtu edhe nga disa udhëzime zyrtare, në të hyrë të majit ai kishte shkuar te thëngjilltari dhe kishte porositur t'i sillnin nxënësinë e plotë të bodrumit të tij të vogël - plot një ton.

Dërgimi i tij iu premtua të kryhej pas një jave, midis orës nëntë dhe dhjetë të mëngjesit dhe, me gëzim të madh, zoti Braun u kthye i sigurt.

Në korrik zoti Braun hoqi dorë duke e mbuluar sallonin me gazeta gjatë ditëve me shi në pritje të ardhjes së qymyrshitësit.

Zoti Braun porositi në gusht edhe njëmbëdhjetë thëngjilltarë të tjerë dhe, sikur të ishte kokëkrisur, ai porositi një ton nga secili prej tyre. Shtatë prej tyre s'e pranuan punën; nga ata që kishin mbetur, vetëm njëri u zotua se mallin do ta dorëzonte pas plot një jave në 8.30 në mëngjes (ose, shtoi ai, midis orës 8.30 dhe nëntë pa një çerek), një tjetër si sot motmot, ndërsa pjesa tjetër në data të ndërmjetme.

Më pas, gjatë po atij muaji, Brauni u shkroi nga një letër prej të marri secilit prej tregtarëve, duke u pohuar se ndonëse ishte treguar i pamend duke kërkuar vetëm thëngjill në porosinë që kishte bërë, në të vërtetë ai ishte i gatshëm të pranonte çfarëdo lënde zëvendësuese që ata furnizonin me atë emërtim. S'kishte mënyrë tjetër se si mund t'ua kujtonte atë punë ai, por meqenëse toni i

ndërlidhjes së tyre qe i lehtë dhe i shpenguar, të gjithë ata që morën letrat pandehën se ajo duhej të përcillte ndonjë fyerje të fshehtë, ndaj porosia u fshi nga blloqet e porosive.

Tregtari i tij fillestar në shtator i tërhoqi vërejtjen për padurimin e tij, duke i bërë me dije se, ndonëse i qenë zotuar që në muajin maj t'i çonin thëngjill, gjithsesi në të njëjtën hall kishte edhe shumë syresh të tjerë që, si ai, iu qe premtuar të pajiseshin në mars apo në prill me thëngjill.

Në tetor zoti Braun filloi të mendonte që ta vriste veten si mënyra më e thjeshtë për të dalë nga ajo gjendje. Ishte me vend që netët për më se një muaj të ishin të ftohta, e tashmë edhe gjatë ditës qe aq ftohtë sa nuk rrije dot qoftë edhe para një prushane pa zjarr. Të rrije atje brenda nënkuptonte të vdisje urie, ndërsa të dilje (shërbyesin e kishin përjashtuar nga detyra e ekonomatit të luftës) nënkuptonte ta humbje qymyrin kur të vinte. Atë mëngjes zotia Braun mori guxim të jepte një këshillë nisur nga qëllime të mira. I shoqi u shtir sikur e pranoi me ironi të stërzgatur. Ndaj, së fundmi, e përlotur zonja doli nga shtëpia që të psoniste,

prandaj tashti burrit të penduar dhe të keqardhur i dukej se më e mira që mund të bënte ishte të dilte dhe të bëhej tym fare.

Mirëpo kumbimi i pazakontë i ziles e kishte tërhequr, kat pas kati (apartamenti i Braunit ndodhej në katin e fundit), ndërsa te porta buçitnin të trokitura të forta. Me mirësjellje instinktive, madje edhe atë çast, muzikanti vajti sakaq t'i përgjigjej, ashtu hutaq, duke shtrënguar fort armën në dorë. Jashtë ndodhej një burrë shtatshkurtër, por truplidhur; një thes i rëndë ndodhej i baraspeshuar mjeshtërisht te supet e tij.

- Keni kërkuar pak qymyr, apo jo, zotëri?

- Kënde, - ia ktheu paksa i shushatur zoti Braun. Atij s'i bëhej vonë nëse qymyri ishte kokërrvogël apo në blloqe njëzet e ca kilogramësh. Ai ecte ndërsa punëtori e ndiqte dhe më pas uli ngarkesën.

- Druaj se të vish gjer këtu sipër është përpjekje e mundim-shme, - u shfajësua Brauni. - Domethënë të ngjitësh edhe thesin, apo jo?

- Oh, por kjo s'ka rëndësi fare, - ia ktheu me dashamirësi qymyrshitësi. - Shihni, unë i kam fort për zemër muzikantët, ndaj kur dëgjova se kishit

mbetur i pashpresë...

- E dinit që unë isha muzikant?

- Po, se ju kam dëgjuar shpeshherë të luani muzikë.

- Vërtet?! S'e paskam ditur që tingujt e violinës sime kanë zbritur gjer poshtë në rrugë. Dhe s'më duket se e kujtoj të më keni thirrur më parë.

- Tash unë thërras më të rrallë. Jo se më vjen turp nga zanati im... apo nga puna që kryej. S'ka burrë nëne që ta thotë këtë për Tom Britënin, zotëri. Edhe kur rastis ta takoj, sikurse më ndodh me raste, dukeshën time...

- Dukeshën tënde?!

- E kam fjalën për hirësinë e saj të Kuinsbërit, zotëri. Ajo është e rregullt në koncertet që jap...

- Koncerte?! Pse, ju dhënkeni koncerte?! Mos mor! Por, qysh... ku... në Sallën e Koncerteve të Mbretëreshës?

- Në Sallën e Koncerteve të Mbretëreshës? Oh, çne, fjala është për një dhomë në nënçati sipër depos së qymyrit që ndodhet përballë Klarkënuellit... disa karrige, një platformë, nga një filxhan kafe dhe muzikë të enjteve mbrëma.

- Kuptoj... sipër depos suaj të qymyrit... ndërsa dukësja vjen rregullisht mbrëmjeve të të enjteve... afërmendsh, pasi

mbyllen shitoret pasditeve... më se e natyrshme... Ju lutem, a s'më thoni se cilës vegël muzikore i bini, zoti Britën?

- Pak të gjithave, zotëri. Kam një violonçel mjaft të mirë norman dhe një harpë holandeze që vështirë se mund t'ia glesh shoqen në Evropë. Por, për dhuntinë që tërheq shumë fisnikë dhe mendjehollë në nënçatinë time, ua kam borxh miqve të mi. Zoti Banistër i bie violinës së parë, sër Roxhër Lestrenxhi violës, zotërinjtë Hjuj, Uilistën dhe ai Shatëlluerth veglave të tjera muzikore, ndërsa me klevicembalin në përgjithësi ia di për nder dr. Pepëshit, kurse i madhi zoti Xhorxh Hendël udhëton zakonisht për në Klarkënuell që t'i bjerë organos sime.

- Zoti Xhorxh Hendëll? Hendëll! - Sytë e habitur të zotit Braun u ngulitën rishtas drejt trajtës shulake, por jo sulmuese, të vizitorit të tij. - Po... po... sigurisht... të mbytë vapa kur ngre këta thasë... një gotë... diçka freskuese?

Buzagaz qymyrshitësi nuk e pranoi ofertën dhe, sikur kjo t'i kujtonte detyrën e tij, ai nxitoi t'ia dilte në krye sakaq punës. Brenda një kohe aq të shkurtër, sa zoti Braun s'e kishte shikuar më parë ndokënd tjetër qoftë edhe nëse bëhej fjalë për gjysmën e ngarkesës, plot njëzet thasë u futën vetëtimthi, dhe pronari i banesës, i lehtësuar pa "bodrumin" t'i mbushej dengëza aq sa s'nxinte më. Megjithatë, ai e shmangu punën e muzikës, ndërsa shkarkuesin e qymyrit s'e dëgjoi t'i kthehej asaj.

- Duket që qenka qymyr i mirë, - vlerësoi Brauni kur po zbrazej thesi i fundit, - ndonëse jo kokërrmadh.

- Qymyri kokërrvogël është më i miri, - qe kundërpërgjigjja. - Ndoshta ai mund të lëshojë paksa erë squfuri kur digjet, por s'çalon puna te kjo, pastaj ai është nxjerrë nga një minierë mjaft e njohur.

- E po, kur të më nevojitet më shumë uroj që të më dërgoni prapë, sepse është hera e parë që ma sillni kaq shpejt.

- Këtë do t'ia them sipërmarrjes ku punoj, zotëri, - tha burri shkurtalëq. - Por, puna është se drejtuesi s'është gjithnjë me të mira... Nganjëherë vërejtjet e vogla i zmadhon shumë.

Zotit Braun iu kujtua diçka vetëm pasi ai kishte ikur. Për shkak të asaj gjendjeje të çuditshme të krijuar, ai harroi ta paguante faturën, të cilën, ç'është e vërteta, as punëtori s'ia kishte paraqitur. Muzikanti vajti me nxitim te dritarja me pamje nga rruga që ta lexonte emrin e karrocës ngaqë ai s'qe i sigurt se cilës shoqërie tregtare i detyrohej. Por ja që në rrugë nuk shihej kurrfarë karroce. Shkallinat qenë të lira. Të vërtetën e vizitës së mëhershme e vërtetonin kurrjë tjetër veçse erëmiria e

këndshme që rrinte ende pezull e pëlhurës së thasëve të veshur me dyllë.

Atë pasdite zoti Braun iu vu punës për ta shlyer llogarinë. Fillimisht iu drejtua furnizuesit të tij që e furnizonte rregullisht, të cilin e gjeti të përfshirë në një përplasje me fjalë që nuk kishin të sosur me një zonjë gjuhëbrisk së cilës i qe zotuar t'i çonte ca qymyr qysh në shkurt. Si dukej, atë s'ia kishin çuar ende, ndaj meqë qeveria rregullonte gjithçka, ajo kërkonte të dinte t'i thoshin se ç'duhej të bënte.

- Mos ma kërkoi mua, - po thoshte burri i mërzhitur kur hyri zoti Braun, sepse s'jam

qeveria.

- Më mirë ty, - ia ktheu ajo ngaqë, sa duket, ata dredhin zinxhirin dhe bëjnë vetëm premtime.

- Ç'u ka ngelur të bëjnë, - iu kundërvu gjithë egërsi ai, - me njerëz si puna jote, xhanëm?!

- Ma thotë mendja që ata duhet të merren me depot e qymyrit, - qe vërejtja e saj thumbuese e ndarjes. - Duket sikur ata janë prerë e qepur për atë punë.

- Çfarë mund t'ju shërbej, zotëri? - kërkoi të dinte admini-stratori i zotit Braun me një zell të papërmbajtshëm.

- Puna është se kishin lënë ca qymyr në banesën time. S'di në

e kishit dërguar ju...

- Ma merr mendja se duhet ta keni dëftesën e dërgesës, apo jo?

- Mjaft e çuditshme, me ç'duket s'paska ngelur gjë, ndërsa unë...

- E po, jo, sepse porosinë tuaj e kemi për javën tjetër. Të enjten, herët në mëngjes. Me shumë gjasë duhet t'ju ketë shtrënguar dikush.

- S'arrij ta kuptoj se si mund të jetë e vërtetë kjo. Punëtori - një tip shtatshkurtër gazmor, i cili s'u ngjit fare shkallëve...

- S'ka qenë asnjë prej njerëzve tanë, - tha me vendosmëri administratori. - Ditën e mirë!

Zoti Braun doli nga zyra dhe vajti në vendin tjetër më të përshtatshëm, pas tij në një tjetër vend. Por askurrkund s'pati sukses.

Në fund kishte mbetur vetëm një zyrë - të paktën ajo më premtuesja. Ai vajti atje sa për sy e faqe dhe nisi avazin tashmë të ditur:

- Keni shpërndarë ca qymyr...

- Po? - iu kundërvu i riu që shërbente, sikur fjalët t'ia kishin shkullur me anë të një gulçimi.

- Që... keni një tablo atje sipër, - belbëzoi me zë të dridhur zoti Braun dhe drejtoi gishtin kah ajo. - A bën ta shoh atë?

- Sigurisht, dha pëlqimin gjithë dashamirësi nëpunësi. - Gjë e vjetër pa vlerë, apo jo? Ai ngriti kapakun e banakut në mënyrë që të kalonte brenda.

Ngjante pikërisht me gravurën e një burri shtatshkurtër, shulak, fytyrëmbël me përparëse të bruztë pune, duke paraqitur në dorë një shtresë qymyrgurore, thua si për të vërtetuar se s'i vinte aspak turp nga zeja e tij. Përposh gjendeshin fjalët: "Tomas Britëni (1654-1714, pas Krishtit). Qymyrshpërndarësi muzikant. Nga tabloja e Galerisë Kombëtare të Portreteve".

- Atë e sollti një ditë qeverisësi i cili e vari këtu, - doli vullnetar të thoshte i riu. - Si i thonë, ai është pak a shumë si shenjti që mbron punën.

- Cili na qenka ai... cili është, a e di?

- Eh, asokohe atë e pashë me adhurim, apo s'duhej ta bëja këtë. Po, ai ishte njeri i madh për kohën e tij. Shitës i vogël qymyri i cili e shpërndan vetë mallin. E, megjithatë, ai njeri, zotëri, në kohë të vet ka qenë një prej muzikantëve më të shquar. Jepte koncerte dhe tërhiqte tërë pasunarët dhe pispilluqët e Uest Endit te depoja e tij e qymyrit diku. Si të thuash, ndonëse i ka gjithnjë në rregull pipëzat me ajkën e shoqërisë, prapëseprapë ai del e sillet vërdallë gjithë kohës për qymyr.


- Atëherë qenka e vërtetë, - murmuriti zoti Braun.

- Oh, ju siguroj, më se e vërtetë! Por kjo s'mbaron me kaq. Përkundrazi, ai është marrë me kimi, astrologji dhe gjëra të tjera që s'kuptoheshin shumë asokohe dhe, në të vërtetë, i doli nami se kishte lidhje me Djallin! Afërmendsh që unë ruhem shumë nga ai.

- Pikërisht, - miratoi me zë të mekur zoti Braun. - Mirë u pafshim!

- Oh, s'ka përse, - ia ktheu me përzemërsi punonjësi i zyrës.

Parku Reivënskort, 1918.



Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademija". E përktheu nga origjinali (anglishtja): Klodian Briçi.

LOUISA BALDWIN

SI E LA AI HOTELIN

Drejtoja një ashensor udhëtarësh te Hotel Empire i cili gjendej në cep të rrugës Bath, një bllok i madh ndërtimi me linja të tullave të kuqe dhe të bardha të cilat ngjasonin me proshutën e vënë në pjatë. Sapo kisha mbaruar shërbimin ushtarak me vlerësime të larta për sjellje. Realisht, me këtë mënyrë e fitova edhe punën.

Hoteli ishte pronë e një kompanie të madhe, me një komitet drejtues nga oficerë në pension dhe me zotërinj me pak para e me mundësi asgjë për të bërë. Ishte edhe koloneli im i ndjerë. Ai ishte një njeri i matur, por që ngurronte kur vullneti i tij nuk bëhej ashtu si atëherë kur i kërkova një punë e më tha: "Mole, ti je njeriu i duhur për të punuar tek ashensori i hotelit tonë të madh. Ushtarët iu përshtaten edhe shërbimeve civile, por edhe atyre të biznesit, dhe publiku i pëlqen ata shumë, mirëpo jo më shumë sesa marinarët. Atij që ishte deri tani, ia treguam udhën dhe ti tani mund të vish në vend të tij".

Puna ishte mjaft interesante dhe paga mjaft e madhe, ndërsa unë do të rrija më shumë se një vit aty sikur të mos ndodhte ajo që ndodhi. Ashensori ynë ishte hidraulik. Asnjë prej atyre gjërave të lëkundshme nuk përplasej si ndonjë kafaz i një papagalli në një shkallë pusi, ndaj nuk duhet të kujdesesha shumë dhe besova me gjithë mend. Ai shkante aq lehtë saqë dhe një fëmijë mund të punonte në të, me një siguri si të qën-dronte në tokë. Në vend se ta lustronim me reklama shkël-qyese si një 'omnibus', në të kishte pasqyra të mëdha ku zonjat shikoheshin në to dhe i rregullonin flokët duke shkuar në katet e poshtme, të veshura me plot stil për një mbrëmje solemne. Ashensori ngjante në një dhomë të vogël me jastëk kadifeje ngjyrë të kuqe ku mjaftonte vetëm të hysh në të dhe të fluturosh lart dhe poshtë, lehtë si një zog.

Secili vizitor hynte në të për t'u ngjitur lart apo për të zbritur poshtë. Disa prej tyre ishin francezë dhe e quanin ashensorin "assenser", mjaft mirë për ta në gjuhën e tyre, padyshim, por pse amerikanët, që mund të flasin anglisht kur ata dëshirojnë, gjithmonë gjejnë mënyra për t'i bërë gjërat më shpejt se njerëzit e tjerë, sikur duhet të humbasin kohë dhe frymë duke e quajtur një ashensor "elevator/ngritës", këtë nuk mund ta kuptoj.

Unë isha në krye të ashensorit nga mesdita deri në mesnatë. Deri atëherë njerëzit

e teatrit dhe ata që darkonin veçse ishin ngjitur lart, dhe kushdo që kthehej më vonë ecte shkallëve sepse orari im përfundonte. Një nga derëtarët punonte në ashensor derisa unë në mëngjes vija në punë, por para orës dymbëdhjetë nuk kishte asgjë të veçantë, dhe jo shumë deri pas orës dy. Pastaj ishte një punë mjaft e ngjeshur me vizitorë që ngjiteshin e zbrisnin vazhdimisht, dhe zilja elektrike binte nga një kat në tjetrin si në një shtëpi të kapur nga flaka. Pastaj, gjatë darkës, zotëronte një magji e qetë, dhe unë uleshja qetë në ashensor ta lexoja gazetën, vetëm se nuk pija duhan. Askush nuk mund të pinte pasi që unë kisha kërkuar nga zotërinjtë e huaj që të mos pinë duhan në të, sepse ishte kundër rregullit. Nuk u thosha aq shpesh zotërinjve anglezë. Ata nuk janë si të huajt e tjerë, që purot e tyre duket se u janë ngjitur për buzë.

Gjersa njerëzit hynin në ashensor unë ua vëreja fytyrat pasi që kisha shikim të mprehtë dhe një kujtesë të mirë. Asnjëri nga vizitorët nuk kishte nevojë të më tregonte dy herë se ku ta çoja. I njihja ata dhe i njihja katet e tyre ashtu si ata vetë.

Ishte nëntor kur koloneli Saxby erdhi në Hotel Empire. E vura re veçanërisht për faktin se dallohej menjëherë që kishte qenë dikur ushtarak. Ai ishte një burrë i gjatë, i dobët, rreth të pesëdhjetave, me një hundë fajkonje të mprehtë dhe mustaqe gri, dhe ecte i ngurtë shkaku i një plage të marrë me armë në gju.

Por ajo që vura re më shumë ishte një shenjë, një e prerë në anën e djathtë të fytyrës. Sapo hyri në ashensor për të shkuar në dhomën e tij në katin e katërt, mendova se çfarë ndryshimi ekzistonte midis oficerëve.

Gjatësia e tij dhe trupi i hollë që kishte koloneli Saxby më kujtoi një postë telegrafike dhe kolonelin tim të vjetër. Koloneli im ishte si një fuçi me uniformë, por një ushtar i guximshëm dhe një zotëri gjithsesi. Dhoma e kolonel Saxby ishte me numër 210, pikërisht përballë derës së qelqtë që të çonte drejt ashensorit, dhe sa herë që ndaloja në katin e katërt, dhoma 210 më vështronte në fytyrë!

Koloneli zakonisht ngrihej me ashensor çdo ditë rregullisht, megjithëse nuk zbriti kurrë me të. Ndonjëherë, kur ishim vetëm në ashensor, ai edhe fliste me mua. Ai më pyeti në cilin regiment kisha shërbyer dhe tha se i njihje oficerët në të. Por nuk mund të them se ishte i qetë për të



biseduar. Kishte diçka që qëndronte larg tij dhe gjithmonë dukej i thellë në mendime. Ai kurrë nuk u ul në ashensor. Qoftë i zbrazët apo plot, ai qëndronte si rrufeja në qiell në këmbë, nën llambë, ku drita e binte në fytyrën e zbehtë dhe faqen e tij të vrazët.

Një ditë shkurti nuk e mora kolonelin në ashensor. E vura re këtë fakt pasi ai ishte i rregullt si një orë zvicerane. Mendova se do të ishte larguar për disa ditë dhe nuk mendova më për të. Sa herë që ndaloja në katin e katërt, dera e dhomës 210 ishte e mbyllur dhe pasi ai shpesh e linte atë të hapur, siguro-hesha që koloneli nuk ishte aty. Në fund të javës dëgjoja një shërbëtore të dhomës teksa thoshte se koloneli Saxby ishte i sëmurë, prandaj mendova se kjo ishte dhe arsyeja pse ai nuk ishte në ashensor kohën e fundit.

Ishte e martë, natë, e unë isha i zënë si rrallëherë. Ishte një trafik i ngarkuar lart-poshtë i cili vazhdoi kështu tërë mbrëmjen. Në ikjen e mesnatës, kur unë isha gati ta fikja dritën në ashensor, ta kyçja derën dhe ta linja çelësin në zyrë për burrin që do të vinte në mëngjes, zilja elektrike ra me mprehtësi. E pashë numrin dhe pashë që isha i kërkuar në katin e katërt. Erdhi ora dymbëdhjetë derisa hyra në ashensor. Ndërsa kaloja katet, të dytin dhe të tretin, pyeta veten se kush ishte ai që kishte kumbuar kaq vonë dhe mendova se duhet të ishte ndonjë i huaj që nuk dinte rregullin e shtëpisë. Por, kur ndaloja në katin e katërt dhe hapa derën e ashensorit, koloneli Saxby po qëndronte i mbështjellë me petkun e tij ushtarak. Dera e dhomës së tij ishte mbyllur pas tij, sepse unë lexova numrin në të. Mendova se ishte i sëmurë dhe i shtrirë në shtratin e tij, edhe pse dukej si të ishte i sëmurë, por ai kishte vënë një kapelë dhe çfarë mund të dëshironte një burrë

që kishte qenë në shtrat dhjetë ditë që të dilte në një mesnatë dimri? Nuk mendoj se ai më pa, por kur unë vura në lëvizje ashensorin, e shikova duke qëndruar nën llambë, duke fshehur sytë me hijen e kapelës së tij, dhe dritën e plotë në pjesën e poshtme të fytyrës, e që ishte e zbehtë vdekjeprurëse, shenja në faqen e tij dukej shumë më e zbehtë se herëve të tjera.

"Gëzohem që ju shoh se jeni më mirë, zotëri", i thashë, por ai nuk tha asgjë, dhe unë nuk doja ta shikoja përsëri. Ai qëndroi si një statujë me mantelin e tij mbështjellë, dhe unë u ndjeva plotësisht i lumtur kur i hapa derën që ai të dilte në sallë. E përshëndeta, ndërsa ai doli dhe më kaloi drejt derës.

"Koloneli dëshiron të dalë", i thashë portierit që qëndroi duke shikuar. Ai hapi derën e përparme dhe koloneli Saxby doli jashtë në borë. "Kjo është një ikje", tha portieri.

"Është", thashë unë. "Nuk më pëlqej pamja e kolonelit. Ai nuk dukej aspak vetja. Ai ishte mjaftueshëm i sëmurë sa të qëndronte në shtratin e tij dhe ja ku është, duke dalë në një natë si kjo". Sidoqoftë, ai kishte mantelin e famshëm që ta mbante ngrohtë. "Unë them, duke supozuar se ai shkoj në një ballo solemne dhe mantelin e kishte për ta fshehur veshjen e tij", tha portieri duke qeshur me shqetësim. Sepse të dy ndihe-shim më të qetë sesa që interesoheshim të thoshim diçka dhe derisa flisnim, një zile e fortë i ra derës.

"Jo më pasagjerë për mua", thashë dhe vërtet kësaj radhe isha duke fikur dritën kur Xhoi hapi derën dhe hynë dy zotërinj të cilët me një shikim i dija se ishin mjekë. Njëri ishte i gjatë, tjetri i shkurtër e i fortë, dhe që të dy hynë në ashensor.

"Na vjen keq, zotërinj, por është kundër rregullit që ashensori të ngjitet lart pas mesnatës".

"Marrëzi!" tha zotëria i fortë, "sapo ka kaluar ora dymbëdhjetë dhe është një çështje e jetës dhe vdekjes. Na çon menjëherë në katin e katërt", tha duke hyrë në lift me shpejtësinë e një të shtëne.

Kur hapa derën ata shkuan drejt e në dhomën numër 210. Një infermiere doli t'i priste dhe mjeku i fortë tha: "Nuk ka ndryshim për keq, shpresoj". Ndërsa unë dëgjoja përgjigjen: "Pacienti vdiq pesë minuta më parë, zotëri". Megjithëse nuk kisha interesim të flisja, ishte më shumë sesa mund të qëndroja. Përcolla mjekët te dera dhe thashë: "Këtu ka një gabim, zotërinj. Unë e zbrita kolonelin me ashensor qëkur

ora ra dymbëdhjetë dhe ai doli jashtë". Mjeku i fortë tha prerë: "Është gabuar identiteti. Ishte dikush tjetër që e morët për kolonelin".

"Duke kërkuar faljen tuaj, zotërinj, ishte vetë koloneli dhe portieri i natës i cili i hapi derën, e njohu atë, po ashtu si unë. Ai ishte i veshur për një natë si kjo, me petkun e tij ushtarak të mbështjellë rreth tij".

"Eja brenda dhe shiko vetë", tha infermierja.

Unë ndoqa mjekët në dhomë dhe atje ishte shtrirë koloneli Saxby. Dukej ashtu siç e kisha parë disa minuta më parë. Qëndronte shtrirë, i vdekur si të parët e tij, me mantelin e tij të madh, i përhapur mbi shtrat që ta mbante ngrohtë e të mos ndiente më të ftohtë. Atë natë nuk fjeta asnjë çast. U ula me Xhonin, duke pritur çdo minutë të dëgjoja kolonelin që i binte ziles së derës së përparme. Të nesërmen, sa herë që zilja e ngritësit binte e mprehtë dhe e papritur, djersa më shpërthente dhe dridhesha përsëri. U ndjeva aq keq sa u ndjeva herën e parë kur isha në veprim.

Unë dhe Xhoe i treguam të gjitha menaxherit, dhe ai tha se do të kishim ëndërruar, duke shtuar: "Merrni parasysh, mos flisni për këtë, ose shtëpia do të boshatiset brenda një jave".

Arkivoli i kolonelit u fut fshehurazi natën tjetër. Unë dhe menaxheri, dhe varrmihësit, e morëm arkivolin në ashensor, duke qëndruar për së gjati, dhe nuk mbeti më vend në ashensor. Ata e bartën atë në dhomën 210 dhe për sa kohë unë prisja që ata të dilnin përsëri, një ndjenjë e çuditshme më pushtoi. Pastaj dera u hap me butësi, dhe gjashtë burra barten arkivolin e gjatë drejtpërdrejt në kalim dhe e vendosën me këmbë drejt derës së ashensorit derisa menaxheri më shikoi.

"Nuk mund ta bëj, zotëri", thashë. "Nuk mund ta zbres kolonelin përsëri. E zbrita dje në mesnatë dhe kjo më mjaftoi".

"Shtyje brenda!" tha menaxheri duke folur shkurt dhe me mprehtësi dhe e nisën arkivolin në ashensor. Menaxheri hyri i fundit dhe, para se ta mbyllte derën, tha: "Mole, ti punove në këtë ashensor dhe, në fund, më habite". Dhe ashtu ishte, dhe pikërisht për këtë nuk do të qëndroja më në Hotel Empire pas asaj që ndodhi, edhe nëse do të ma dyfishonin pagën. Dhe kështu, me portierin e natës, u larguam së bashku.

Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Fortesë Frangu-Paçarada.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ekipi olimpik sot pritet me ceremoni shtetërore


PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Sot, më 2 gusht, në orën 19:50, ekipi olimpik i xhudos do të zbarkojë në Aeroportin e Prishtinës "Adem Jashari". Ekipi që i solli vendit dy medalje të arta olimpike do të pritet me ceremoni shtetërore. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka dërguar agjendën e pritjes e cila është ndarë në dy pjesë. "1. Pritja ceremoniale shtetërore në Aeroportin 'Adem Jashari' në

orën 19:50, me ç'rast mbahet konferencë për media. 2. Ardhja e Kampionëve Olimpikë në sheshin 'Nëna Terezë' në orën 21:00", ka njoftuar MKRS-ja. Në Aeroportin "Adem Jashari" në konferencë për media do të dalin trajneri Driton Kuka, trajneri Agron Kuka, Distria Kranisniqi, Nora Gjakova, Akil Gjakova dhe zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani. Në sheshin "Nënë Tereza" rreth

orës 21:00 qytetarëve do t'u drejtohen kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, trajneri Driton Kuka, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova. Në Lojërat Olimpikë Tokio 2020 Republika e Kosovës ka fituar dy medalje të arta. Distria Krasniqi në kategorinë deri në 47 kilogramë dhe Nora Gjakova deri 57 kilogramë e bënë krenare Kosovën në Japoni.



KOK-u nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Komitetin Olimpik të Portugalisë



Prishtinë, 1 gusht (ER) - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar të dielën memorandum bashkëpunimi me Komitetin Olimpik të Portugalisë. Memorandumi u nënshkrua në Tokio të Japonisë nga drejtuesit e dy komiteteve olimpikë. Për KOK-un nënshkruan presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, ndërsa për Komitetin Olimpik të Portugalisë, presidenti Jose

Manuel Constantino dhe sekretari i përgjithshëm, Jose Manuel Araujo, derisa i pranishëm ishte edhe këshilltari i presidentit Krasniqi, Besim Aliti. Presidenti Krasniqi e ka vlerësuar lart nënshkrimin e këtij memorandum, duke thënë se KOK-u do t'i marrë përvojat më të mira nga Komiteti Olimpik i Portugalisë, duke bashkëpunuar ngushtë në projekte të ndryshme. Nga ana e tij, presidenti Manuel

Constantino, duke urrear presidentin Krasniqi për dy medaljet e arta olimpikë, ka shprehur kënaqësinë që do të bashkëpunojnë dhe do t'i japin përvojat më të mira të tyre për KOK-un. Gjatë takimit u përmend edhe njohja e Portugalisë për Kosovën shtet, për çka presidenti Krasniqi falënderoi homologun e tij. Në fund, u shkëmbyen dhuratat mes të dyja palëve.


Fisnik Rugova transferohet te Rahoveci

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Fisnik Rugova është larguar nga Prishtina dhe ka nënshkruar me Rahovecin. Vreshtarët këtë lajm e kanë bërë me dije me anë të një postimi në faqen e tyre në rrjetin social "Facebook", duke theksuar se me afrimin e qendrës prishtinase do të bëjnë gjëra të jashtëzakonshme. Rahoveci për Rugovën është skuadra e tretë e Kosovës ku më parë, përveç Prishtinës, ka luajtur edhe për Pejën. "Përvojë të gjatë në basketbollin e Kosovës. Sportist brenda e jashtë palestrave. Lojtar i shquar e me ndikim. Të gjitha këto predispozita japin shpresa të mëdha se KB Rahoveci e Fisnik Rugova, së bashku, mund të bëjnë gjëra të jashtëzakonshme. Fisnik Rugova është 32-vjeçar i gjatë 207 cm dhe luan në pozitën e qendrës. Ai ftohet rregullisht edhe në përfaqësuesen e Kosovës", ka njoftuar KB Rahoveci.



Shaqiri mund të rikthehet në Bundesliga

PRISHTINË, 1 GUSHT - Xherdan Shaqiri, sipas të gjitha gjasave, do të largohet këtë verë nga Liverpooli. Sulmuesi nga Kosova edicionin e kaluar nuk pati shumë hapësira te The Reds dhe kërkon një skuadër ku mund të luajë rregullisht. Paraqitja fantastike në Kampionatin Evropian ka bërë që shumë skuadra të vihen pas tij. Lazio, Napoli, Villarreal, Galatasaray e Fenerbahce janë skuadrat që duan transferimin e gjilanasit, por së fundmi në garë është futur edhe skuadra gjermane Hertha Berlin. Skuadra nga kryeqyteti gjerman po ndërton një ekip të mirë dhe synimi është të rikthehet në garat evropiane. Drejtori sportiv i Herthës, Freddie Bobic, ka pranuar se i pëlqen shumë Shaqiri.





K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Në bazë të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 02.08.2021 shpallë këtë:

KONKURS

Pozita: Menaxher i njësisë operative, me kontrate pune një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi, pune provuese gjashtë (6) muaj, Vendi Deçan (1 pozitë).

Detyrat e punës janë:

- Menaxhon më njësinë operative, harton propozim planin vjetor të punës dhe kujdeset për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, përcjell realizimin e planit vjetor, është përgjegjës për disiplinën në punë dhe azhurnimin brenda njësisë.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës:

- Diploma universitare drejtimi ekonomik, bujqësisë ose juridik,
- Përvoja e punës prej 3 viteve në vende të ngjashme të punës.

Pozita: Inkasantë , me kontrate pune një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi, Vendi Pejë: (4 pozita), Deçan: (3 pozita), Istok: (1 pozitë).

Detyrat e punës janë:

-Bëjnë pastrimin e kanaleve të ujitjes sipas planifikimit nga Menaxheri i Njësisë, bëjnë kontraktimin e ujit, shpërndarjen e ujit, dhe pagesat nga fermerët, më rastin e pagesave janë të obliguar të lëshojnë kontrata dhe dëftesat e pagesave.

Kushtet për themelimin e mardhenjës së punës.

- Kualifikimi i mesëm shkollor,
- Përvoja e punës 1 vjeçare, ne lami të ngjashme.

Pozita: Vozitës – Përgjegjës për eskavator (1 pozite) me kontrate pune një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi, pune provuese gjashtë (6) muaj Vendi Pejë.

Detyrat e punës janë:

Vozitësi, organizon dhe koordinon punën me eskavator dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tij,
Propozon masa mbrojtëse në vend të punës dhe jep llogari për punët e kryera.

Kushtet për themelimin e mardhenjës së punës.

- Shkolla e Mesme,
- Përvoja e punës 2 vjeçare në vozitje të eskavatorit.

Procedura e aplikimit:

Dokumentet dorëzohen në zyrën nr. 1 të KRU "Drini i Bardhë" rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkëgjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës së punës,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjëse.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Shodno Uredbi o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji poslova i radnih obaveza, RKV "Drini i Bardhe" dd, 02.08.2021. Godine objavljuje sledeće:

KONKURS

Radno mesto: Rukovodilac operative jedinice, sa ugovorom o radu na godinu (1) godine sa mogućnošću produženja, probni rad šest (6) meseci, Dečan Mesto (1 mesto).

Zadaci su:

- Upravlja operativnom jedinicom, izrađuje godišnji plan rada i stara se o korišćenju i održavanju imovine, prati sprovođenje godišnjeg plana, odgovoran je za radnu disciplinu i ažuriranje u okviru jedinice.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:

- univerzitetska diploma iz ekonomije, poljoprivrede ili prava,
- Radno iskustvo od 3 godine na sličnim poslovima.

Položaj: Sakupljači, sa ugovorom o radu (1) godinu dana sa mogućnošću produženja, Mesto Peć: (4 pozicije), Dečani: (3 pozicije), Istok: (1 mesto).

Zadaci su:

- Očistite kanale za navodnjavanje prema planu upravnika jedinice, izvršite ugovaranje vode, distribuciju vode i plaćanja od poljoprivrednika, u slučaju plaćanja morate izdati ugovore i potvrde o plaćanju.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa.

- srednja stručna sprema,
- 1 godina radnog iskustva, imamo slične oblasti.

Radno mesto: Vozač - Odgovoran za bagere (1 pozicija) sa jednog (1) godinu ugovora o radu sa mogućnošću produženja, uslovno šest (6) meseci Mesto Peć.

Zadaci su:

- Vozač organizuje i koordinira rad sa bagerom i stara se o njegovom održavanju,
- Predlaže zaštitne mere na radnom mestu i odgovara za obavljene posao.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa.

- Srednja škola,
- 2 godine radnog iskustva u upravljanju bagerima.

Aplikacija postupak:

Dokumenti se dostavljaju u kancelariju br. 1 RKV "Drini i Bardhe" ulica "Mbretëresha Teute" Br. 85 Peć.

Uz prijavu morate priložiti sledeće dokumente:

- CV (biografija),
- Kopija lične karte, dokaz o radnom iskustvu,
- Shkoll školska diploma za potrebnu kvalifikaciju - kopija,
- Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od šest (6) meseci.

Rok za podnošenje prijave je 15 dana od dana objavljivanja konkursa i završava se u 16:00 časova, odgovarajućeg dana.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Administrues i bazave të të dhënave (zyrtar i lartë)
Departamenti: Teknologjia Informative
Divizioni: Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
Grada: 5
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve

Administruesi i bazave të të dhënave krijon, instalon, konfiguron dhe administron bazat e të dhënave të bazuara në Oracle dhe MS SQL Server, dhe ofron shërbime shfrytëzuesve që përdorin aplikacione bankare dhe jobankare.

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Administron bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen në Departamentin e Teknologjisë Informative;
- Planifikon krijimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave. Punon ngushtë me administratorët e sistemeve gjatë instalimit të aplikacioneve të cilat lidhen me bazat e të dhënave;
- Instalon versione të reja të databazave dhe veglave të saj, si dhe veglave të tjera të nevojshme për qasje në baza të të dhënave;
- Vlerëson versionet e databazave, veglave ndihmëse, në mënyrë që të sigurojë se baza e të dhënave punon sipas standardeve. Në bashkëpunim me administratorët e tjerë dhe zhvilluesit e aplikacioneve, planifikon përditësime me ndikim minimal në punën e sistemeve;
- Administruesi i bazave të të dhënave është edhe pikë kontakti me Oracle dhe Microsoft Support, si dhe kompanitë e tjera që kanë aplikacione dhe baza të të dhënave në BQK;
- Shkruan procedura (Ang. "stored procedures") të cilat përdoren për nxjerrjen e raporteve nga bazat e të dhënave në MS SQL Server dhe Oracle;
- Shkruan dokumentin udhëzues për përdorim të databazave;
- Rregullon problemet e ndryshme në bazat e të dhënave, aplikacioneve, komunikimin në mes tyre dhe veglave të tjera të cilat raportohen nga shfrytëzuesit;
- Monitoron dhe në rast të problemeve, rregullon problemet me komunikim në mes të databazave dhe aplikacioneve të ndryshme;
- Konfiguron bazat e të dhënave për "high availability";
- Planifikon, implementon dhe teston në mënyrë të vazhdueshme procedurat për backup dhe restore të bazave së të dhënave;
- Kryen proceset e EOD (End of Day) pas mbylljes së orarit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqës-i/ja.

Njohuritë e kërkuara:

- Njohuri të shkëlqyeshme në administrimin e bazave të të dhënave të bazuara në Oracle dhe MS SQL Server;
- Njohuri të shkëlqyeshme në dizajnimin logjik dhe fizik të bazave të të dhënave;
- Aftësi të kryej rregullime në performancën e bazave të të dhënave;
- Të jetë i aftë të ofrojë strategji gjatë zhvillimit të bazave të të dhënave;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme në shkrimin e query të ndryshëm sipas nevojave dhe natyrës së punës;
- Njohuri të mirë të menaxhimit të të drejtave të shfrytëzuesve të bazave të të dhënave;
- Përvojë në migrime të bazave të të dhënave;
- Njohuri në performancë tuning të bazave të të dhënave;
- Përvojë në T-SQL apo PL/SQL;

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Shkallë universitare (bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo matematikës, ose certifikime profesionale për Microsoft SQL: MCSA: SQL Database Admin, MCSA: SQL Server, Oracle Database Administration Certified Professional, Oracle Certified Associate (OCA), Oracle Certified Professional (OCP);
- Përvojë 2 vjeçare në administrimin e bazave të të dhënave;
- Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **16 Gusht 2021**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAŠAVANJE O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Pozicija: Administrator mreže (viši službenik)
Departman: Informaciona tehnologija
Odeljenje: Informacione tehnologije i sistema
Stepen: 5
Izveštava kod: Rukovodioca Odeljenja Informacione tehnologije i sistema

Administrator mreže odgovoran je za administraciju, poboljšanje i unapređenje mrežne infrastrukture informacione tehnologije. Takođe je odgovoran za informacionu sigurnost u mrežnoj infrastrukturi.

Odgovornosti i dužnosti rada:

- Instalira, konfigurise, administrira i održava sve mrežne komponente (Router, Firewall, Switch, VOIP i drugu mrežnu opremu) koje su deo IT infrastrukture u CBK.
- Konfigurise i održava vezu (VPN) sa drugim institucijama.
- Analizira zahteve za promenu ili dodavanje funkcija u mreži CBK i pruža adekvatna rešenja.
- Blisko saraduje sa administratorima i tehničarima unutar odeljenja i sa službenicima Odeljenja za informacionu sigurnost i kontinuiteta rada.
- Obrađuje nalaze iz izveštaja o nadgledanju i bezbednosti informacije.
- Služi kao drugi nivo suočavanja sa incidentima i problemima svim korisnicima informacione tehnologije.
- Rešava probleme koje su prijavili unutrašnji i spoljni korisnici mreže CBK.
- Nadgleda i meri učinka mrežnih komponenti, uključujući CBK opremu koju koriste spoljni korisnici.
- Održava licence i komunicira sa spoljnim dobavljačima usluga.
- Planira i pruža rešenja zasnovana na merenjima komponenata kako bi se osigurao kontinuitet i sigurnost mrežnih usluga.
- Održava dokumentaciju o konfiguracijama, kreira procedure i priručnike za svu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Učestvuje aktivno u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranju.
- Aplicira bezbednosne smernice i standarde.
- Ostale dužnosti koje dodeljuju odgovorni u hijerarhiji Departmana za informacione tehnologije

Kvalifikacije i iskustvo:

- Diplomirani inženjer računarstva (Bachelor) ili relevantni sertifikati u vezi sa ulogom mrežnog administratora, CCNP, PCNSA, JNCIA.
- 2 godine iskustva u mrežnoj administraciji. Poželjno je iskustvo u mrežnoj sigurnosti.
- Poželjna iskustva u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Iskustvo ili sertifikacija u željenom ITIL-u.
- Poželjno je engleski jezik.

Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kome se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije / organizacije potkrepljen dokazima Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo MONT mora službeno priznati / nostrifikovati;
- Dokazi o identitetu i o stalnom prebivalištu na Kosovu;

Procedura apliciranja:

- Rok za apliciranje je **16 Agust 2021**.
- Apliciranje se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti razmatran.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa službene internet stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

